



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, *Agjencia e Statistikave të Kosovës* shpallë:

KONKURS

1. Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit, një (1) pozitë të karrierës:

Titulli: Një (1) Udhëheqës i Divizionit të Regjistrimit

Numri i referencës: ASK-DRA-001

Koeficienti: 9

Detyrat dhe përgjegjësit:

1. Udhëheqësi i Divizionit të Regjistrimeve në vazhdimësi do të jetë përgjegjës për funksionimin dhe realizimin e projekteve të Regjistrimeve në kuadër të Agjencisë së Statistikave të Kosovës.
2. Angazhohet në përgatitjen, zhvillimin dhe implementimin e Regjistrimeve si dhe pjesëmarrje aktive në përgatitjen e të gjitha Dokumenteve, Raporteve dhe Publikimeve të Regjistrimeve dhe Anketave të mëdha.
3. Siguron krahasueshmërinë ndërkombëtare të instrumenteve, metodave si dhe metodologjinë për Regjistrimet në pajtim me rregullativen ligjore në fuqi.
4. Angazhohet në freskimin dhe azhurnimin e databazës dhe regjistrave të ndryshëm nga regjistrimet.
5. Harmonizon planin e punës me Departamente tjera të ASK
6. Merr pjesë në realizimin dhe zhvillimin e dinamikës të aktiviteteve për regjistrime të ndryshme,
7. Kryen edhe punë tjera që dalin nga Departamenti Regjistrimeve dhe Anketimeve dhe Departamentet tjera të ASK.

Kualifikimi: Diploma e Fakultetit ekonomik, Sociologji-demografi apo të ngjashme.

Përvoja e punës: Përvojë pune 5 vite, përvojë në menaxhim, të njohë metodologjitë statistikore për analiza e hulumtime.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohja e mirë e gjuhëve zyrtare – e nevojshme,
- Njohuri të mira me kompjuter e sidomos programet softuerike për analiza – e nevojshme,
- Shkathtësi në udhëheqje dhe koordinim me zyre rajonale – e nevojshme,
- Ruajtja e konfidencialitetit – e nevojshme .
- Azhur dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave të punës – e nevojshme.

2. Departamenti i Statistikave Sociale , një (1) pozitë të karrierës:

Titulli: Një (1) Zyrtar i lartë për statistika të tjera sociale

Numri i referencës : ASK-DSS-002

Koeficienti : 8

Detyrat dhe përgjegjësit :

1. Këshillon njësinë e statistikave të tjera sociale,
2. Bënë përpunimin dhe analizimin e të dhënave të statistikave të mirëqenies sociale,
3. Kontribuon në përpunimin dhe analizimin e të dhënave të statistikave të arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe sportit,
4. Mban takime te rregullta me përfaqësuesit e MPMS, MASHT, MSH dhe MKRS,
5. Bën përgatitjen e publikimeve statistikore për statistikat të mirëqenies sociale,
6. Mbikëqyrë të gjitha fazat statistikore (përgatitjen e instrumenteve statistikore, grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe publikimin e të dhënave të statistikave të tjera sociale),
7. Përgatitë raportet javore , mujore dhe vjetore për njësinë e statistikave të tjera sociale,
8. Kryen detyra te tjera shtesë sipas kërkesës së shefit të divizionit të statistikave sociale dhe Drejtorit të DSS.

Kualifikimi:

Përgatitja Universitare , Diplomë Universitare në shkencat Sociale , Ekonomi , apo në ndonjë fushë tjetër relevante.

Përvoja e punës: Kërkohej njohuri te thella dhe te specializuara te fituara permes shkollimit universitar , trajnime perkatëse ne fushën e statistikave sociale si dhe kandidati duhet të ketë përvojë pune tri vite , si dhe njohuri ne statistikat sociale .

Kompetencat dhe aftësitë:Aftësi të mira të komunikimit, për punë ekipore, njohja e gjuhës angleze e preferueshme, aftësi të larta në përdorimin e kompjuterit (Wordit , Excelit , SPSS) dhe të Internetit.

Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore.

Procedura e konkurimit:

Ne Shërbimin Civilë kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore , të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar , përgatitje të nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin funksionit administrativ dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë bëhet në pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civilë.

Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës , në të cilën është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarik nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencionin e Statistikave të Kosovës, Rr. "Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin , përvojën ,veritetimin nga Gjykata që personi nuk është nënë hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme , që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurroni.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit me gojë.

Për informata të hollësishme , mund të kontaktoni me zyrën e personelit , në tel: 038- 20031149 , prej orës 08:00 – 16: 00.

“Shërbimi Civilë i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.